



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**

*Sesioni pranveror*

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 17

Prishtinë, më 7.5.2018, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Ganimete Musliu, Enver Hoti, Salih Salihu dhe Driton Çausi.

Munguan: Andin Hoti, Danush Ademi, Liburn Aliu dhe Srđan Mitrović.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Daut Haradinaj**, kryetar i komisionit.

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit;**
- 3. Shqyrtimi i planit të veprimit për biodiversitetin 2016-2020;**
- 4. Shqyrtimi i raportit vjetor 2017 i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës;**
- 5. Të ndryshme.**

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së fundit**

**Kryetari i komisionit** konstatoi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.4.2018.

**3. Shqyrtimi i planit të veprimit për biodiversitetin 2016-2020**

**Kryetari i komisionit, Daut Haradinaj**, falënderoi z. **Ismaj Hetemaj** nga MMPH për pjesëmarrje edhe pse ndoshta nuk ka pasur nevojë që ky dokument të dërgohet në Kuvend pasi më 2011 është miratuar si e tillë, megjithatë ja dha fjalën z. Hetemaj për sqarime të duhura.

Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020, **vazhdoi z. Hetemaj**, është dokument me të cilin MMPH i planifikon Veprimet që duhet të ndërmerren me qëllim të arritjes së objektivave strategjike të Strategjisë së Biodiversitetit. Strategjia dhe Plani i Veprimit në Biodiversitetin 2011-2020 është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 7.10.2011.

Me këtë Strategji afati i të cilës ka qenë 10 (dhjetë) vjeçar është miratuar njëkohësisht edhe Plani i Veprimit për pesë vitet e para (2011-2015). Për të qenë e zbatueshme Strategjia 2011-2020, ministrisë i ka parë të nevojshme që të përgatitet Plani i Veprimit për pesë vitet e mbetura të kohëzgjatjes së Strategjisë, pra PVB 2016-2020. Plani i Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020 pas kalimit të procedurave është miratuar më 29.3.2018 nga QRKS.

Gjatë hartimit të Planit të Veprimit 2016-2020 në Grupin Punues ndërministror kanë marrë pjesë, përveç të tjerëve, edhe zyrtarë nga Zyra për Planifikim Strategjik, Ministria e Integritetit Evropian dhe Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural etj.

Duke pasur parasysh faktin se në Ligjin nr. 03/L/233 në mënyrë specifike nuk thuhet se Planin e Veprimit duhet ta miratojë edhe Kuvendi (pasi që ekziston Strategjia e miratuar 2011-2020), e kemi adresuar për miratim në Qeveri. Gjatë punës në Grupin Punues ndërministror ka pasur edhe propozime që Plani i Veprimit të jetë trevjeçar për shkak se Korniza Afatmesme e Shpenzimeve është trevjeçare. Të gjetur në një situatë të tillë, zbrazëtirave ligjore dhe procedurave jo të qarta të miratimit, si bartës i hartimit të këtij dokumenti vlerësohet se miratimi i Planit të Veprimit 2016-2020 në Qeveri e bën dokumentin e zbatueshëm duke pas parasysh që në Strategjinë (2011-2020) objektivat strategjike kanë mbetur të njëjtat (ato që janë miratuar në 2011).

Synimet janë që gjatë Ndryshim- Plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, i cili edhe për arsye të tjera pritet të ndryshohet dhe plotësohet kjo materieje do të specifikohet me saktë e veçanërisht rreth procedurës së miratimit të Planeve të Veprimit.

**Salih Salihu** u interesua çka parasheh MMPH me planin për biodiversitetin, kurse përgjigja e shkurtë ishte se ky plan i ka 4 objektiva, të rriten sipërfaqet e mbrojtura, resurset të menaxhohen më efektivisht dhe me sukses në aspektin e mbrojtjes së natyrës në Kosovë, veprimet të bëhen me afat dhe kostoja të dihet.

**Kryetari** kërkoi sqarime a ka ndërhyrje esenciale pasi kërkohet edhe njëherë miratim nga Kuvendi i këtij plani, përgjigja ishte negative por pas vitit 2020 me siguri Qeveria do të parasheh gjërat më saktë dhe nuk do të ketë nevojë për sqarime detale, siç kanë mbetur deri tani disa çështje, megjithatë ai tha se brenga e kryetarit nuk duhet të qëndrojë sa i përket përfshirjes së ligjeve të BE në këtë plan ngase Ligji për mbrojtjen e natyrës është i transpozuar 100%.

**Ganimete Musliu** pyeti çfarë mendon z. Hetemaj kur theksoi zbrazëtirat ligjore dhe cilat janë ato, në mënyrë që të rritet angazhimi i komisionit në atë drejtim. Përgjigja ishte se nuk është fjala për ligje, por nga aspekti i planit të veprimit duhet të veprohet më tepër.

**Driton Çausi** potencoi miratimin nga Kuvendi të raportit të gjendjes së mjedisit 2016, ku ka pasur mjaft zbrazëti sa i përket biodiversitetit, zonave të mbrojtura, shkatërrimin e pyjeve etj., që d.m.th. se është mjaft jo-optimiste kjo fushë sa i përket mbrojtjes së natyrës, njëherit pyeti a ka ndonjë objektivë MMPH apo informacion.

**Z. Hetemaj** tha se Kosova ka shpallur 11% të territorit parqe nacionale, ngase ashtu është konfiguracioni ballkanik dhe është dashur të veprohet ashtu. Mirëpo sa i përket mbrojtjes së tyre duhet ende mjaft punë duke krijuar bazën ligjore, sidomos në mbrojtjen e pyjeve për të cilat ende vazhdojnë polemikat midis dy ministrive se kush duhet t'i mbrojë, Ministria e Bujqësisë thotë se kompetenca i takon asaj dhe ajo nxjerr ligjin për pyje, mirëpo MMPH gjithashtu

potencon se parqet nacionale ku janë edhe pyjet i mbron ajo, shpejt në Kuvend do të dërgohet ligji për pyje.

**Besa Gaxherri** tha se i kemi parasysh të gjitha këto fakte mjaft shqetësuese për shkatërrimin e florës e faunës, por a është e gatshme Kosova (MMPH) për BE sa i përket biodiversitetit?

**Z. Hetemaj** theksoi se palë nuk jemi ngase nuk jemi në OKB, por garantoj se Kosova gjithnjë i përcjellë hapat e duhura dhe është në rrjedhat e proceseve të BE- së.

**Enver Hoti** gjithashtu parashtrori disa pyetje konkrete duke u nisur nga ligjet të cilat i mungojnë Kosovës në këtë drejtim për të shfrytëzuar mundësinë për intervenime nga ky komision dhe sa është vepruar nga MMPH prej vitit 2011 dmth prej vitit të miratimit të këtij plani, kurse probleme potenco disa, gjithnjë duke u bazuar në shënimet nga dokumenti i dorëzuar Kuvendit.

**Z. Hetemaj** premtoi se ato duhet dhe do të rregullohen me dispozita të qarta ligjore.

**Salih Salihu** vazhdoi me problematikën kryesore, siç tha ai të pyetjeve të cilat nuk mbrohen, por ka edhe tjera siç janë gurthyesit, ndotjet e lumenjve, migrimi i rinisë nga fshati në qytet (debalans i biodiversitetit) etj., ndaj pyeti për hapa që duhet të ndërmerren për shpëtimin e mjedisit.

**Z. Hetemaj**, për shkak të ngjashmërive të pyetjeve, tha se fillimisht duhet penalizimi i dëmtuesve dhe veprimeve pa leje, gjithsesi ligjet e natyrës të harmonizohen me ligjet e tjera që sigurojnë zhvillimin e biodiversitetit, e jo të mbyllen sytë para dëmeve siç janë shfrytëzimi i zhavorrit në lumenj dhe shumë dëmeve që i bëhen natyrës.

Pas pyetjes nga **Besa Gaxherri** se a ka ndonjë dënim nga gjykatat në Kosovë për këto shkatërrime, dhe pas përgjegjës negative dhe ndërhyrjes së **kryetarit** se ka mjaft dënime, **z. Hetemaj** tha se dënime veç e veç për dëme ka (Hani Elezit, Ferronikli etj.),por nuk ka asnjë padi deri tani për shkatërrimin e biodiversitetit.

**Kryetari** potenco se nuk përputhen të dhënat që flet zyrtari këtu dhe të dhënat që janë shënuar në dokument, megjithatë ftoi komisionin për deklaram.

Komisioni vendosi si vijon:

## REKOMANDIM

**Mbledhja plenare të miratojë Planin e veprimit për biodiversitetin për periudhën 2016-2020.**

### **4. Shqyrtimi i raportit vjetor 2017 i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës**

**Kryetari Daut Haradinaj** falënderoi pjesëmarrjen e drejtorit, z. Idriz Blakaj, të cilin e ftoi të paraqet raportin njëvjeçar të Agjencisë, por fillimisht shprehu mendimin se ky raport është mjaft i mirë edhe pse dihen problemet e agjencisë me staf dhe problemet e tjera financiare, të projekteve etj. Ainjëherit premtoi se ky komision do të angazhohet sa më urgjent të kryej ligjin për kompleksin e Adem Jasharit, i cili nismë është dërguar në Qeveri për mendim, pastaj do të vazhdoi procedimi në Kuvend.

**Idriz Blakaj** falënderoj kryetarin e komisionin dhe vazhdoi me raportimin duke potencuar problemet e cekura nga kryetari; fillimin mjaft problematik të punës së kësaj agjencie-bartja e projekteve nga MMPH te kjo agjenci, të cilat probleme 99% janë eliminuar. Mirëpo potenco dhe përsëriti kërkesën rreth mungesës së stafit, për çka ministria e financave ka premtuar plotësim

buxheti të menjëhershëm. Ai falënderoi stafin ekzistues për përpjekje të dyfishtë rreth realizimit të obligimeve ligjore, por edhe potencoi disa kërkesa pa të cilat vështirë e ka kjo agjenci, p.sh. mungesën e arkitektit të licencuar për konservim, projektin e Mejës etj., njëherit kritikoi Ligjin ekzistues për prokurim i cili ligj bazohet në çmimin më të lirë, me çka vazhdimisht bëhen dëme të gjithanshme të cilat më vonë vështirë do të riparohen.

**Ganimete Musliu** e kupton ngecjen sa i përket kompleksit Adem Jashari për shkak se ende nuk u krye ligji, por kërkoi informacion për projektet e tjera, siç është rivarrimi i dëshmorëve në komunën e Llapit, realizimin final të projektit për Morinën dhe disa projekte të tjera, për të cilat z. Blakaj dha sqarime të sakta dhe arsyet pse deri tani nuk kanë përfunduar (sqarimet dhe pyetjet ishin të hollësishme të tipit pse kjo periudhë, pse familjarët nuk pajtohen etj.)

**Enver Hoti** konstatoi se raporti tregon që kemi të bëjmë me një agjenci jo fort të organizuar mirë, kërkoi realizimin sa më të shpejtë të kompleksit Adem Jashari ngase ky projekt ndërlihet me vetë shtetin tonë, për projektet e tjera tha se nuk janë në fazën e kënaqshme të planifikimit, p.sh. Në Meje nuk ka pasur procedura të realizimit që d. m. th. a janë ngritur penalizimet e duhura për zbatimin e procedurave (edhe pse fajësohet Ligji për prokurimin, ai kërkoi njoftimin pse vazhdojnë punët pa ngritur asnjë penalizim), pse nuk janë realizuar udhëtimet dhe vizitat (pyetje edhe nga **Besa Gaxherri**) etj.

**Z. Blakaj** tha nuk mund të fajësohet kjo agjenci për shkak se ka kursye, mirëpo z. Hoti iu kundërvu sepse vizitat mund të janë të obligueshme p.sh. për ekspertiza. Ai potencoi disa fakte p.sh. “nga kjo agjenci ndodh të tërhiqen parat pa na pyetur askush” etj.

**Kryetari** falënderoi për raportimin, kurse komisioni për raportin vjetor të AMKMK vendosi:

## REKOMANDIM

**Të miratohet nga mbledhja plenare raporti vjetor 2017 i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.**

### Të ndryshme

**Kryetari** në këtë pikë njoftoi komisionin për disa trajnime që do të mbahen dhe që janë në interes të deputetëve, një deputet mund të lajmërohet nëse dëshiron nga anëtarët e komisionit dhe premtoi se përmes stafit do të njoftohen më hollësisht.

Për delegacionin nga Ajova të SHBA- së, njoftoi se nesër mbahet takimi në orën 10,00 për të cilin takim konfirmuan edhe tre anëtarë të tjerë të komisionit, përveç kryetarit.

Kryetari njoftoi se pas mbledhjes takohet GP për nismën e Ligjit për ndryshime e plotësime të Ligjit për shërbimet e ujit dhe mund të marrë pjesë kush dëshiron nga komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12,30.

E përgatiti:

**Stafi mbështetës i komisionit.**

Kryetari i komisionit,

-----

**Daut Haradinaj**